



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1690/16 Prot.

Tiranë, më 24.11.2021

V E N D I M

Nr. 53 datë 24.11 2021

“PËR

PAGESËN E ANËTARËVE TË JURIVE

TË MBROJTJEVE TË TITUJVE AKADEMIKË”

Mbështetur në pikën 1, 2,c të nenit 3, nenit 49, të Ligjit Nr.80/2015 ”Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, në pikën 5 , kreu IV, të VKM nr. 112 datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor”dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, në pikën rr, neni 43, të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, si dhe në nenin 24, të Rregullores së UST-së, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 24/11/2021,

V E N D O S I:

1. Të miratojë pagesën e anëtarëve të jurive të mbrojtjeve së titujve akademik, si më poshtë vijon:
 - Kryetari dhe oponenti 8 (tetë) orë mësimore ;
 - Anëtarët 5 (pesë) orë mësimore.
2. Pagesa e anëtarëve të jurisë mbulohen nga të ardhurat e Universitetit, pas lidhjes në kontratës më personat e përcaktuar sipas rastit, në përfundim të raportimit të përcjellë nga komisioni i përhershëm i promovimit të personelit akademik.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i promovimit të titujve akademike, Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet tek www.ust.edu.al dhe trasparenca universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

HYSEN DOMI

